

26.06.2020
1662 prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT
DEGET E SHOQERIVE PUBLIKE NE RRETHE

Nr. 59, Prot.

Shkoder, më 26/06/2020

Lënda: Dergojme material per afishim

Drejtuar: Bashkise

Malesi e Madhe

Ne zbatim te VKM Nr. 926, date 29.12.2014 "Per kriteret e vleresimit te prones shteterore, qe privatizohet apo transformohet dhe proceduren e shitjes", Kapitulli III, Pika 6, germa "c", kerkojme nga institucioni juaj te beni afishimin per shitje sipas listes bashkelidhur kesaj shkrese.

"Ish Repart Ushtarak" ne Tamare.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin !

PERGJEGJESE E DEGES

Elsa ELBASANI



Konceptoi: E.Elbasani

Godina e Trajtitimit te Studentave Shkoder , elsaelbasani@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të VKM Nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", i ndryshuar, shpall për shitje si më poshtë:

1. Në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes

Nr	Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + truall)	Mjete kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Prona nr. 1224 "Ish-Repert ushtarak"	Tamarë	22 642 970	21 751 292	891 678	3860.08	647.69	01.07.2020	11.30	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndermarjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
2. **Mandat pagesën apo Garancinë bankare** në original që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shenim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndermarja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndermarjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
2. **Mandatpagesën apo Garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.
3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.
4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.
5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parblerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se,

që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish- Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë. Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare apo mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethet faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit. Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al